



Datë: 09.09.2025
Numër Protokolli: 6046/2025

A.nr.1406/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, më Kaltrina Avdullahi Prenaj si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1406/2025, të datës 18.07.2025, të parashtruar nga ankuesja A.T, kundër organit të punësimit: Inspektorati Qëndror i Punës, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 09.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1406/2025, e datës 18.07.2025, e parashtruar nga ankuesja, A.T.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile A.T, (në tekstin e më tejme referuar: *Ankuesja*), më datë 18.07.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin, për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit, lidhur me kërkesën e datës 27.11.2024, për kompensimin e pagesës së përvojës së punës sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.K079/23, si dhe Vlerësimit të Kushtetueshmërisë së Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Inspektoratin e Punës, ndërsa, kjo fundit, nuk ka dorëzuar provat e kërkuara nga Këshilli lidhur me kërkesën e parashtruar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesit, është e pasafatshme, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesja është e punësuar në Inspektoratin Qendror të Punës, dhe se e njejta sipas Akt emërimit me numër Nr.336/2022, të datës 31.10.2022, mbanë pozitën e punës *Inspektor i Punës*. Rrjedhimisht nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesja më datë 27.11.2024 ka parashtruar kërkesë në organin përkatës të punësimit, për kompensimin e pagesës në vlerë prej 0.25 % të pagës për çdo vit pune gjatë 15 viteve të para të përvojës së punës, ndërsa, pas 15 vite përvojë pune ka kërkuar kompensimin e pagesës në vlerën prej 0.5 % të pagës, pasi që është dëmtuar në pagën bazë dhe përvojën e punës.

Si rezultat i heshtjes administrative të organit të punësimit ankuesja më datë 18.07.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin ankimor për realizimin e të drejtës në kompensimin e pagesës në vlerë prej 0.25 % të pagës për çdo vit pune gjatë 15 viteve të para të përvojës së punës, ndërsa, pas 15 vite përvojë pune ka kërkuar kompensimin e pagesës në vlerën prej 0.5 % të pagës, tutje shton se organi i punësimit nuk e ka zbatuar Aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese Nr.K079/23, e që rrjedhimisht sipas ankueses e njejta është dëmtuar në pagë. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj organin e punësimit për kompensim të bëj kompensimin e përvojës së punës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publike, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: *3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 98, paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.....* si dhe nenit 124 paragrafit 1 dhe nenit 127 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *Neni 124 paragrafi 1, 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, Neni 127 paragrafi 1: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*, dhe si rrjedhojë duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankueses e parashtruar në Këshill më datë 18.07.2025, është ushtruar jashtë afatit ligjor, për faktin se ankuesja lidhur me kërkesën për kompensimin material, e ka parashtruar pranë organit të punësimit më datë 27.11.2024, dhe duke qenë se ankuesja nuk kishte pranuar përgjigje branda afatit prej (45) ditësh, atëherë e njejta kundrejt heshtjes administrative të organit të punësimit në raport me kërkesën e datës 27.11.2025, mund të parashtronte ankesë në Këshill, jo më herë se (7) ditë dhe jo më vonë se (2) muaj, pas skadimit të afatit në përgjigje në kërkesën e datës 27.11.2024. Andaj, mbi këtë bazë dhe duke qenë se ankuesja me asnjë provë nuk ka argumentuar se e njejta pas kërkesës së datës 27.11.2024, ka ndërrmarë veprime tjera (kërkesa), lidhur me kompensimin e pagesës në vlerë prej 0.25 % të pagës për çdo vit pune gjatë 15 viteve të para të përvojës së punës, ndërsa, pas 15 vite përvojë pune ka kërkuar kompensimin e pagesës në vlerën prej 0.5 % të pagës, atëherë në këto rrethana rrjedhë se ankesa e ankueses me numër A.nr.1406/2025, është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e Nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kontekst të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji thekson faktin se hedhja poshtë e ankesës me numër A.nr.1406/2025, nuk e privon ankuesen nga e drejta që e njejta të parashtrtoj kërkesë të re pranë organit të punësimit për realizimin e të drejtës së pretenduar në ankesë, pos çdo herë duke i respektuar afatet e parashkrimit sipas Ligjit të Punës, si dhe afatet për parashtrimin e ankesës në rast të heshtjes së sërishme administrative.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1406/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, A.T;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.